


Fatos Arapi

BIBLIOTEKA

854-1
A 73



KU
SHKONI
JU, STATUJA...
poezi

8PL883-1

814-1
A73

FATOS ARAPI

KU SHKONI JU,
STATUJA...

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»


Redaktore
SEVIM ARBANA

Piktor
KSENOFON DILO

Recensues

Bardhyl Londo
Besnik Mustafaj

Endrra
tē mia...



QENKA MË VËSHTIRE ...

Më lodhi avalanshi i figurave poetike...

*Qenka më vështirë t'i thuash botës
diçka të kthjellët (të vogël?), —*

*t'i thuash, për shembëll: ja, unë u ula
e nën qiparisa i mora dy gogla,
e me to po lozja, si lozim përditë —
kur pa e kuptuar vargun e madh e përfola:*

«Urrej gjithë perënditë»¹.

*Qenka shumë më vështirë t'u thuash njerëzve
diçka të pathënë, të ndershme,
t'u thuash, për shembëll:*

*ju u ngjani fëmijëve,
që gjumi s'i zë pa lodrat e vogla nën përkresë.
I kërkojnë nëpër gjumë,
me duar i shtrëngojnë gjer nesër.*

Ashtu mbani ju nëpër jetë dashuritë.

Më lodhi avalanshi i figurave poetike, ::.

1. Varg nga «Prometeu i lidhur» i Eskilit

ENDRRA TE MIA...

Endrra,
ju jeni tē rënda
Shpeshherë kërrusem
rën barrën tuaj.

Ju ngarkoni mbi mua
grimcëza dritash mendimi,
rrezëllime tē gëzueshme lirie,
dhimbje epokash tē tëra. *islep*

(Mbi shpatullat e rrizuillit ato po t'i hidhnit,
do ta shihja si do t'i palosej
peshku i kurrizit).

Ju jeni gatuar prej tē gjithave:
prej gjuhësh tē panumërtë dashurish,
pëshpërima muzgjesh
e paqesh.

Endrra,

ju jeni të rënda;
ju ngarkoni mbi mua kafshimet e urive;
Fytyrat e përgjakura, të dhemshura të lirive;
ju ngarkoni mbi mua varrezat e dëshmorëve
të të gjitha kohëve,
të të gjithë popujve

Dhe bri tyre — si ata —
ju vetë bini tek unë
nëpër funerale gjigante ashtu ...

Endrra të mia,
ju jeni të rënda.
Dhe unë s'e kam lehtë me ju ...

NJË PËRKRESE ME GJETHE ULLIRI TE KOKA ...

*Një përkresë me gjethë ulliri te koka. —
Nuk vdes sot. Le ta lëmë për nesër ...*

*Gjelbërosh gjer në palcë, si ulliri,
do të punoj në veten time
ekzistencën e dhimbshme të kohës, —
ta ushtroj atje poshtë të mos ndalet:
cerberët do të jenë ca kulishë të zbutur;
karontët pe gjasme, si në teatrin e kukullave.
Vetëm lumi le të jetë i vërtetë,
të rrjedhë duke kënduar këngët*

polifonike të tij.

*Prej kohe në brigjet e Akeronit jam një ulli i gjel-
bër. —*

Dhe nuk vdes sot.

Një përkresë me gjethë ulliri te koka.

KU SHKONI JU, STATUJA...

I.

*Ku shkoni ju, statuja
të porsazbuluara prej toke?*

(*Nëpër udhëtim të pandalshëm,
të tjera e të tjera po ngjiten
shtresave të dheut — për të ardhur tek ne.
Me këmbë të thyera, duar të humburi,
njëra pas tjetrës,
pa krye,
pa trup,
nëpër qënien time po ecin,
si nëpër shtresat e dheut
ku kanë rënë).*

*Në këtë korridor të ngushtë të ditës,
në bardhësi antike,
para meje qëndrojnë kohërat foshnje,
kohërat nëna.*

II

*Ku shkoni ju, statuja,
të ngrira në bardhësinë e ftohtë,
të mermertë?*

*Dhe ç'udhëtim i çuditshëm qenka ky juaji?
Përse duhej të kalonit kështu nëpër mua,
kur unë vetë
mezi gjeta një udhëz, ku të eci
nëpër veten time. —
Një udhëz që të vi gjer tek ju ...*

*Përse duhej shekuj e shekuj
me errësirën e tokës të tretështit
e të qëndronit pastaj para meje, —
veten tuaj ta shihnit tek unë:*

Si shembëlleni, si?

*Ju i ngjani vetvetes,
apo unë juve?*

III.

*Zgjohuni.
Nuk jam aktor tragjik
dalë prej veprave të lashtësisë.*

*Mes jush,
si në arenën e një amfiteatri të braktisur,
qëndrova*

e thirra ...

Veç zërat e mi nuk shkokan tutje.

Kthehen e mblidhen sërisht tek unë ...

Atëherë brenda vetes sime thërras:

nuk jam aktor tragjik

dalë prej veprave të lashtësisë.

Zgjohuni ...

Jo me bukurinë e mermertë, të lëmuar, —

brenda gurit, — si njeri,

me njerëzit të bisedoj dua.

IV.

*Ku po më çon kjo murmurimë e trishtuar,
e mermerta juaj?*

Plagët e hershme ju therin në trup.

Mbi to ballin mbështeta.

Me ballin tim preka

*fragmentet e bukurisë së lashtë,
të dhimbjes suaj.*

S'mjaftokan plagët e këtij shekulli, —

dhibjet e gjithë kohëve

u dashka të ngremë nëpër trup?

V.

*Mbi ato plagë ballin mbështeta.
Dhe murmurita: statuja,
na duhej dhe vdekja dhe rilindja juaj.*

*Në këtë funeral të përgjithshëm
ju po më merrni për dore. —*

Ku po më çoni?

*Eci midis zbehtësisë së gëzueshme
të shikimeve tuaja, —
dhe mbetem ai që jam.*

*Nuk dua fytyrën time ta transplantoj
në shtatin tuaj të bardhë;
as dua, si despotët e hershëm,
frymëmarrjen e ngrirë të mermerit
ta marr trofé në varr.*

*Eci midis zbehtësisë së gëzueshme
duke murmuritur:*

*na duhej dhe vdekja
dhe përlindja juaj.*

VI.

*Në rrjedhën e paçlodhshme të shekujve,
brenda lindjes, brenda vdekjes udhëtonim.*

*Dhe pranë copërave tuaja — eshtrat tona...
Shpeshherë,
nëpër baltra të errësirës së ftohtë,
— ne dhe toka —
fragmentet e mermerta
me kocka skeletësh
ngatërronim.*

Nëpër gjymtyrët tuaja — eshtrat tona.

VII.

*Ku shkoni ju, statuja
të porsazbuluara prej toke?*

*Pa krye,
pa trup,
nëpër qënien time ecni, —
si nëpër shtresa të dheut.*

Shekulli XX. . .

*Të hutuara shihni sytë ironikë,
shtatin gjigant hekurçelik.*

*Ju merren mendtë prej shungullimit të dritave,
dridheni, keni frikë,*

*Thellë shikimeve tuaja
rrapëllimë e vdekjes së njëhershme
ka ngrirë.*

*Dhe mendoni: — Ndofta më mirë
ishim atje nën dhé ... Ndofta më mirë:*

VIII

*Rënkimi juaj
ronitet prej meje
si kokrrizat e rërës prej shkëmbit të detit.*

*Dhe unë po ju them: statuja të mia,
mos flirtoni me plagët që morët:
Nuk ka kuptim
të dashuroheni kështu
me trishtimet e dhimbshme
të kujtimeve tuaja.*

*Unë mezi gjeta një udhëz
ku të eci nëpër veten time; —
një udhëz
që të vij gjer tek ju.*

*Dhe të ndiej se si, nëpër ftohtësinë
e mermertë,
para meje çlironen epoka të tëra.*

IX

Ç'është kjo klithmë e kobshme skllavi,
që tejpërtej shpoi harrimin?

Perënditë marrkan fytyrën e kësaj robine?

Para meje, këtë çast, ajo ulërimë
zërdhcë nër pala mermari
dhe ngrin ...

... dhe më duket sikur
brenda kraharorit të gurtë
shekulli vetë përpëlitet,
thua të ish një pëllumb
në dorë të kësaj dite — fëmijë;

... dhe më duket sikur
dora e dashurisë, që ju krijoi juve,
edhe tani mbjell statuetka^{të} shenjta
nëpër hapësirat e mia të pafundme;

... dhe më duket sikur
nëpër shtatin tuaj, në gurë,
buzët e mia prekin epitafet e lirive,
që varre nuk patën kurrë.

X.

*Ku shkoni ju, statuja
të porsazbuluara prej toke?*

Shekulli XX ...

*Shekulli im Atlas
mban mbi shpinë jo globe tokësore.
Ngarkesa të gjithë ngrenë,
sado qofshin të rënda.*

*Shekulli im
mban mbi shpinë globe të tëra resh
e mjegullash e shirash e ëndrrash.*

Globe të tëra tragjedish njerëzore.

*Dhe sytë e tij të mirë,
me bebëzat e mia të gëzuara,
para jush zvogëlohen — sikur të shihnin
përflakjen e shndritshme të diellit
nëpër një agim blu.*

*Bukuri të gjymtuara,
tërë plagë në trupin e heshtjes së thellë ...
Jo vetëm ne — ju vetë u drodhët
e brenda jetës suaj shtangët,
kur patë dashurinë tonë për ju.*

JEMI BËRË PREJ LAVDIE POETIKE ...

*Kerko ngej lemn
1925*

*Jemi bërë prej lavdie poetike tashmë.
Nëpër «unet» poetikë hyjmë e dalim,
nëpër Panteonët, desha të them.*

*Kërkojmë vendet me dritë, gjuajmë dritëhijet,
zgjedhim kryevendet --- dhe vetë ne
i vendosim truporet tona pranë një Safo,
bri një Migjeni (47 kilësh kur vdiq).*

*Në përjetësi harruar,
ne, të gjallët e pavdekshëm,
shkelim kufirin e urtë të erës dhe të rërës.
Truporen standard e blemë në punishte. —
Tani mbetet vetëm koka . . .*

Në e gdhendtë skulptori.

45935

... BËN SIKUR

... bën sikur merr frymë
 njeriu që më shkon ndanë; në një pikë
 tëngrirë kohe ecën,
 shkel mbi harrimin e jashtëkohës.

Ai bën sikur lëshon hije mbi tokë, lëvrin.
 Sikur mendon,
 sikur dashurohet,
 sikur trishtohet . . .

Eshtë njeri, apo jo?! Edhe ai lidh në zemër
 dhimbjen e shenjtë të lindjes së krizantemës . . .
 Dne bën sikur jeton,
 sikur vdes.

HIPOKRIZI, NUK JE E BUKUR ...

Hiprokrizi, nuk je e bukur.

*Nuk është çështja tek dy fytyrat e tua.
 Mijëra vjet dëgjoj parazërin e prapazërin tënd ...
 Po ti nuk je e bukur, hipokrizi.
 Jam një pikë diellore
 lëshuar pingul
 gjireve të thella t'oqeanit të jetës, —
 po të takoj ty ... dhe shpërbëhem në ajër!
 Vetëm ndjesia se ti më avitesh
 e vret frysma marrjen e dritave të mia.*

Hipokrizi, nuk je e bukur, jo.

MË NJERËZORE ...

Zili, bëhu pak më njerëzore ...
Më takon në rrugë,
më përshëndet,
më jep dorën.
Të përshëndes,
të jap dorën,
buzëqeshim ...
Ç't'i bësh! Fat njeriu, apo jo?!
Ti ecën e vetëkënaqur
si një metaforë poetike,
përjetësisht e përjetshme ...
Ashtu qofsh!

Por pakëz, një grimëz,
më njerëzore, Zili ...

SI MUND TË KALOHET LLOGORAJA PA TY?

*Si mund të kalohet Llogoraja pa ty?
 Me një kokërr portokalle në dorë,
 Llogoraja si mund të kalohet pa ty ...
 Të pengohesh nëpër, folera yjesh,
 të zgjosh e të trembësh zogjt' qiellorë
 që fluturojnë e fshihen fundeve të detit ...
 Një dhimbje bardhësie të kaltër,
 njerëzore gjer në përjetësi!
 Në duart e mia,
 ky dallgëzim qiellor i deteve,
 si dikur drithërimë e përmallshme e ijeve
 të tua imcake.*

*Ky mall i përjetshëm Llogoraje
 më mbeti në sy.*

*Akrokeraunet
 vazhdojnë punën e tyre të përhershme:
 prodhojnë vetëtima.*

STUHIA . . .

*Njërin krah të pulëbardhës e mbushte jugu,
tjetrin krah tramundana.
Në gojë të dallgëve e reve
klithje e zogut digjej nën shira.
Mbi mua e nën mua: shpirti
apokaliptik i një perëndie të egër.*

*Gjeni e poezisë — buzëqesh
dhe sundoje tani kaosin!*

Vlorë, më 27 mars 1989

NJË ZOG I MADH . . .

*Një zog i madh e i hirtë këndonte
 dhe ecte në tokë para meje; errësira e natës
 kishte shkopsitur kraharorin atje,
 ku majat e fullimta e të përmalluara
 të Malit të Thatë
 ishin zgjuar, —
 përpara se rrezja aguese të binte mbi to.*

Një zog i madh e i hirtë ecte para meje.

*U ZVERDH LIGJËRIMI I DALLËNDYSHES
SHTEGTARE ...*

U zverdh ligjërimi i dallëndyshes shtegtare.

*Vetëtijnë retë që ulen, shkreptin. —
Dhe kokrrën e rrufesë e thëthin
zemr'e liqertë e mallit për ty.*

U zverdh ligjërimi i dallëndyshes shtegtare.

MJELLMA E LIQENIT TE OHRIT ...

*E uli qafën e brishtë
tek brinjë e Orionit.*

*Derdhur e tëra prej malli. —
Mbi konstelacione yjesh
e fatesh lundron,
hutim i bardhë, mospërfillës i ligenit.*

*Befas shpirti i natës ndizet,
shkru mohet në këngën e saj.*

*Brerimë e lotëve shuan,
atje përposh, —
prushanën e ndezur të Mjellmës Boreale:*

DASHURITË JANË TË SHUMTA . . .

*Dashuritë janë të shumta, dashuritë janë të ndryshme:
ca me faqe të buta,
ca me buzë të shijshme.*

*N'errësirë na puthin e na ledhatojnë,
e ditën s'na njohin —
bëjnë sikur s'na shikojnë.
N'errësirë na puthin e na ledhatojnë
dhe pastaj na harrojnë . . .*

Dhe pastaj i harrojmë:

II

*Dashuritë janë të shumta, dashuritë janë të ndryshme:
nëpër heshtje na shpojnë
shikimet e trishtme.*

*E në qafë na varen, prej qafe s'na shqiten;
ngjeshen brenda kraharorit, në vakuum të rriten.
«Ah, të mundje, i dashur, të jetoje pa ajër!
Ah, të mundje, i dashur, mos jetoje fare!».*

Dhe kanë frikë nga trishtimi,
 dhe tmerrohen nga vjeshta;
 nëpër trupin e tyre
 shkruajnë
 e shuajnë arabeska.

III

Dashuritë janë të shumta, dashuritë janë të ndryshme:
 përmbi hala qerpikësh
 ulen pupth dallëndyshet.

Nën takat e tyre derdhet lumi i ditëve.
 Nën majë të takave kumbon lumi i dritave.
 E përsipër: mbi to të gjalla, të vdekura
 ndehen orët, minutat çahen shegë të pjekura.
 Kullon lëngu i kohës... Me grusht e rrufitin,
 se sa hap e mbyll sytë, u ikërkajeta...

Edhe zbehen ashtu përmes dritash të zbehta.

IV

Dashuritë janë të shumta, dashuritë janë të ndryshme.
 Zhytenëndrrat e mia
 nëpër malle të trishtme.

*Ne i ndiejmë pranë vetes dhe aherë, kur s'janë.
Ne e dimë se diku me ne
ato janë.*

*Dhe sa herë të lodhur nga udha e rëndë,
kur këmbët na merren e na merren mendtë,
shtrijmë dorën e mbahemi (jo mbi shkopin e drunjtë),
po në supin e tyre të brishtë e të butë.*

V

*Dashuritë janë të shumta, dashuritë janë të ndryshme:
Puqur valëve të Drinit
gjarpërojnë dallëndyshet.*

*Na lakohen në qafë, si një gëzim i ngrohtë,
të lehta, flurore, kurse ne s'i ngrejmë dot.
I kërkojmë, i zbulojmë në çdo sy e fytyrë,
na trishton vetë gëzimi që ato janë tonat.*

Na trishton gjer në dhimbje bukuria e tyre.

Ato janë me ne edhe nëpër harrime.

*I përcikim sapak e në majë të gishterinje
drithërohen tek ne edhe toka, dhe qielli.
Me mornicat e shtatit të shenjtë të tyre,
diku nën pëllëmbën tonë lidhetjeta.*

Diku nën pëllëmbën tonë zgjohetjeta.

VI

*Dashuritë janë të shumta, dashuritë janë të ndryshme.
 Shkrijnë ngricat qiellore
 nër shikime të brishtme.*

*I përqikim sapak e në majë të gishtërinjve
 fërgëllon përjetësia e gëzueshme e tyre.*

Dhe ashtu ne kalojmë nëpër vjet edhe shekuj.

*Dhe fytyrën e tyre ua japim lirive,
 dhe fytyrën e tyre ua japim
 drejtësive.*

Page

KISHTE ÇELUR LULJA E ULLIRIT...

Kishte celur lulja e ullirit.

Asaj nate, sigurisht, ajo qe me mua.

Unë nuk i fola për aeroportet,

për ndarjet;

nuk i fola për trishtimet supermoderne.

Pikonte mbi ne nata juleulliri... ref'cencë.

Unë nuk i fola asaj për nostal gjitë e metropoleve,
për kuptimin e vdekjeve të dashurive të mia.

E ndolla me sy dhe në heshtje i thashë:

— Sonte kam nevojë, më pritet firoma,

s'jetoj dot pa regtimin e trupit tënd,

s'jetoj dot pa shpirtin tênd të ullirët.

Ajo qau.

Unë s'e shtriva dorën t'i fshija lotët.

ESHTË NJË LOJË . . .

*Eshtë një lojë e madhe, e dashur,
lodrojnë fjalët, ritmet, rimat;
përqafohen figurat, vijnë rreth dritave,
si fluturave prej flakëve*

*u përcëllohen krahët,
ato prapë gicilohen me dritat.*

*Lojë e hapësirave,
që mbyllen të gjitha në buzët e tua,
kur ti vet' qenke në buzët e jetës
firomë e mërmërimës së tyre.*

*Eshtë një lojë e vërtetë, e dhemshura ime;
lojë e mjegullave, që treten nëpër agime,
për të rilindur mbrëmjeve në gjire të fushës
së detit;*

e legjendave, që jetojnë midis mjegullave,

SA ÇEL E LIDHET VJESHTA ...

*Dhe pak dhe kryeartëzat
do të ulen tek unë,
nëpër muzgje ullinjsh.*

*Me shirat e tectorit
do t'u pikojnë prej syve
brerimat dritëullirta.*

*Dhe pak ...
dhe Unë e Malli,
me ty do të takohemi,
sa çel e lidhet vjeshta.*

Trishtimet do të çmallen.

N D A R J A ...

*Ishte një muzg i pikëlluar,
ishe një hënë mospërfillëse.
Në gjysmën tjetër të qilllit duke udhëtuar,
e dija: do të qaje për mua, do dënesje.*

*Fjalës «lamtumirë» i binin rrokjet në udhë,
gërmat një nga një zbërtheheshin, avullonte, humbiste.
S’të kapja dot më n’horizont që humb;
s’të kapja dot më: ishe ti apo s’ishe ...*

*Tek unë zgalemi i plagosur rrokullisej furtunës
dhejeta e vdekja klithnin në një klithmë të bardhë, —
atje ku ndarja ka fundin
dhe nis prap’ fillimin e saj.*

MOJ E VOGËLA SA LOTI ...

populli

1.

*Në sytë ëndërr dhe s'jemi parë.
 Unë gjysmëvdekur, ti gjysmëgjallë,
 në një buzëqeshje tok kemi qarë,
 në një pikë loti:
 të dy vdekur, të dy të gjallë.*

2.

*Më verboi syrin ky lot kristal.
 A je ti mall, apo ç'je vallë?
 Eci dhjetorit e shkel në maj,
 dhe brymë, dhe pjalm dhe ngricë acar:
 një pikë loti — dy gjysma ndarë:
 dhe vdekja ime,
 dhe vdekja e saj.*

3.

*Ti prej harrimi e tëra e gjallë.
Në mes të udhës, kohës acar,
s'më lë të shoh loti kristal:
në halë qepalle rruzullin mbaj,
në një pikë loti pa fund e skaj —
mbaj Dashurinë
dhe Universin tragjik të saj.*

Oh, ti e vogëla sa loti!

A JE BRYMË, MOJ, A JE BORË?

populli

*A je brymë, moj, a je borë?
 A je frymë apo je gojë?
 A je dorë që ledhaton?
 Udhë që ecën e s'mbaron?
 Sy i shuar që shikon?
 Terr që natën ma ndriçon?
 A je sy apo je vetull?
 Dashuri që flet e vdekur?
 A je valë, a je lumë?
 Ti je loti e syri unë?
 Ti je buza e unë buzëqeshja?
 Je gënjeshtra e vërtetë?
 A je jetë nëpër vdekje
 apo vdekje, moj, nëpër jetë?*

SA QAVA PËR ENDRRËN, MOJ ...

populli

Evë!

*Ashtu nëpërëndërr,
gjithë ëndrrën e ëndrrës,
kush thirri i pari:
Unë
apo Adami?*

*Kur i hapa sytë
dhe s'të gjeta pranë, —
Evë!*

*Qaj' e qaj përëndrrën ...
Bri meje gulçonte
stërgjyshi
Adam.*

*VARRIN MOS MA BĒNI THELLĒ:
GJER NĒ GJOKS T'ASAJ SĒ MJERE*

populli

Vdekja ime nē gjoksin e saj . . .

*Merrem vesh mirë unë dhejeta.
Merrem vesh mirë unë dhe vdekja.
Duam tē flemë? — Flemë.
Duam tē zgjohemi? — Zgjohemi.*

*Merren vesh mirë jeta me vdekjen:
Duan tē lozin? — Lozin.
Duan tē qajnë? — Qajnë.*

*Shpirt i hënës piklon blir nē maj.
Vdekja ime nē gjoksin e saj . . .*

MOTIVE NGA BERLINI : : :

1.

*Në këtë qytet verior erdha
si një hutim i pakapshëm.
Mbaj në sy Adriatikun e përmbysur
dhe hetoj qiejt: Mjellma Boreale,
e hutuar si unë, a do të ulet aty?*

*... Mbaj në sy Adriatikun përmbysur
dhe hetoj qiejt ...*

2

*E panjohur ecja e erës dhe e hijeve,
 dhimbja-mall i një melodie në mbrëmje;
 e panjohur druajtja prej shikimit shpërfillës
 të një leshraverdhe me aroma të panjohura.
 Mendoj: në fund të fundit — vdekja,
 ç'mund të ketë këtu të panjohur?*

*Më është i panjohur
 kryeqyteti i shpirtit tënd këtu, dashuri.*

3.

Një ecje tjetër, të tjera zërat e shiut këtu.

*S'kërcet gjëmimi i bronztë i maleve të mia,
oshëtima shungulluese s'kthehet prapa
të më mbështjellë sërish e sërish.*

Se si është ecja, flurimi i shiut këtu ...

*Afshi avullues i shtatit të kësaj femre të lagur,
pëllumbat në Kurfurstendamm,
kishat e kohërat gjyntuar prej luftërave.*

*Një shpirt i gjerë, i butë shiu derdhet këtu,
breron mbi mua si mbi një ulli të gjelbër,
që ecën dhe e ndien se rrënjet e tij
— ashtu si në Jug — shkojnë poshtë të ushqehen
nëpër nekropole të vjetra.*

REKUIEM PËR H.F. KARAJANIN

*Në qoftë se sot zemrat tona ngrihen të murenjtura
 në dhimbjen e tyre të Akrokerauneve; në qoftë se
 dënesja e dy deteve — Adriatikut dhe Jonit —
 pëplaset e thyhet aty, —
 dirigjenti i stuhisë atëherë
 me një shkop vetëtime në dorë,
 le ta nisë rekuiemin!
 Në ag shekujsh të mugët
 thërrmoheshin elegjitet e shenjta,
 kumbuese.*

Tani le të mbulojnë ty.

*Zérat e tingujt qiellorë
 të lindjes dhe vdekjes së stërkalave, —
 i kthehen detit . . .*

Dhe ti ishe det.

II. Vellezërit e pegasit

VËLLEZËRIT E PEGASIT

etyd

*Hutim i lashtë me sy të urtë,
 të mirë ...*

Ndanë një vture, nën një semafor.

Elegantë. Prej drite dhe ere.

Kreshpërohen.

Hingëllijnë

vëllezërit e Pegasit. Flurorë.

Dalë si prej shpirtit të thellësive të tokës ...

Me xhufka diellore në ballë —

turfullojnë

kuajt e Kosovës.

*DY HERË NËNË**dëshmorit Jonus Peja*

*Vlora është dy herë nënë, këtu.
 Dy herë Pejë-Peja te ky varr.
 Dy herë më e thellë plaga;
 dhe kënga ime këtu duhet të jetë
 e përrjetshme sijeta,
 sepse shqiptari i moçëm e tha:
 «Kur po më l'shojnë andrrat,
 po m'kapin dhimbat ...»¹.*

1. Varg prej eposit populor.

VAJET E BALLKANIT

1

Shkruumojnë natën antike vajet e Ballkanit.

Zëri i parë vjen prej kohësh të moçme.

Zëri i dytë vjen prej kohësh bizantine.

Zëri i tretë ka qenë dhe është përherë

*ngashërim i mbytur
i zemrës së njomë të Ballkanit.*

2

Prodhon shumë varre toka e Ballkanit.

Tumba, nekropole, varre, të pavarrosur. —

Bimësi përjetësisht e gjelbër,

ujitur prej Danubit të lotëve,

prej Drinit të lotëve.

Kanë ç'të kullosin vdekjet e Ballkanit.

3

Dasmat janë simotra të vdekjeve, në Ballkan.

Vdekjet janë simotra të dasmave, në Ballkan.

*Unazat prej rrezëllimi zjarri të shuar,
ndizen në gishtërinj të tretur dhëndurësh.*

Si mund të bëhet pa një vajtim në Ballkan?

Ballkani s'mund të jetë më Ballkan.

*I doni në një oktavë superiore?
Janë nënët që qajnë më shumë, —
me vargje poetike qajnë . . .
Janë etërit që dënesin më tepër, —
prozë e ashpër antike . . .*

*Vdekjet kanë sy epikë,
buzëqeshje të varfra stoike. —
Si mund të jenë ndryshe vdekjet
në vajet e Ballkanit?!*

*Ka një notë fondamentale në vajet e Ballkanit.
Diafonike,
heterofonike,
homofonike.
polifonike. —*

*Ka një notë fondamentale
mu në zemër të vajeve të Ballkanit.*

6

*Janë hutuese nënët e Ballkanit:
 përjetësisht në të zeza,
 kokë më kokë rrëth një varri, —
 si korbat rrëth kafshatës së bukës.
 Këndojnë... vaje
 në një harmoni sublime.*

Ashtu e ka...

Ashtu e do edhe sot e kësaj dite Ballkani.

7

Shpërthyese dhe tepër të vetvetishme vajet e Ballkanit.

*Ku u gjend ky plumb armiku
 që të mori ty! —
 Në u pafshim në atë botë,
 bir'i nënës ...*

*Tonet, gjysmëtonet,
 frekuencat, luhatjet, —
 lëndë e mirëfilltë estetike
 e vdekjeve dhe vajeve të Ballkanit.*

8

*Vdesin prej zemre në Ballkan,
 prej kancerit, prej Sidës vdesin.
 Ka një mikrob të pashërueshëm,
 atavik Ballkani — plumbin.*

*Do tē thotë vriten djem,
do tē thotë vriten vasha,
do tē thotë vriten fëmijë. —*

*Mozaikë vajesh Ballkani:
vajtojnë vetëm liritë.*

9.

*Vdekje me zurná,
vdekje me guséll,
vdekje me gérnetë. —*

*Hahen zérat në një «ritém strikt»,
shkrihen zérat në një «ritém librë».*

Si t'i doni:

lloj-lloj ceremonialesh ritesh e vdekjesh ka Ballkani.

10.

*Monovdekje.
Plurivdekje.*

Mikrovdekje.

Makrovdekje.

*Periodizim i substrateve antike tē vdekjeve,
Ballkani?*

*Jo me ujë, —
me gjak tē lirive tē njoma,
shpëlajnë duart Pilatët në Ballkan.*

ORAKUJ TË ERRËT

shovenëve

1

*Orakulli im arkaik e i vjetër,
në verbërinë e tij flet me veten,
diçka më thotë për jetën e për vdekjen:
thua sikur vetë unë s'jam jetë,
thua sikur unë s'e njoh vdekjen ...*

*Unë, lastar qiparisash të gjelbër,
loz edhe çloz me dy gogla të rëna:
këtu hedh diellin e atje pres hënën,
këtu hedh jetën e atje pres vdekjen.*

Loz edhe çloz me dy gogla të rëna.

2.

*Orakulli im? Sy i gjaktë i egër,
nër thyerje netësh shfaqet ndër ekrane,
me gjuhë litanirash, me të madhe,
më parathotë Lirinë e të Ardhmen.*

*Thua sikur unë s'qenkam Liri!
Thua sikur unë s'qenkam e Ardhme!*

3

*Thua sikur unë nuk i njoh honet,
s'ia njoh humnerat shpirtit të Ballkanit,
ku verbérojnë Vampirët e Lemurët,
nër netët-qull ulërijnë ulërima
mbi popuj — fli e liri — viktima.*

*Thua sikur unë nuk i njoh honet,
s'i njoh greminat e shpirtit të Ballkanit.*

4.

*Ata nër shpella të mesjetës s'errët,
kokëposhtë, përgjumur ngulur nëpër terr,
shëmtirë neveritëse e mjerë,
në letargji liturgjike të tyre, —
shikojnë kokëposhtë rruzullin që rrrotullohet:
diçka më thonë për shekullin që largohe... .*

*Kur unë fëmijë — edhe vetë pa e ditur —
tek shihja diellin që përthyej në det,
rrezet pérndezëse valës së Adriatikut, —
me gisht skicoja shekullin XX. . .*

5

*Ata nér shpella tē mesjetēs sē errët,
 kokëposhtë, putrat ngjitur nēpér terr,
 me shputa kalbin, gërryejnē errësirën,
 nē zgavra terri sajojnē mbretërira,
 ngjallin sérish perandorët kufoma, —
 mbi popujt — fli e dashuri tē njoma.*

*Në èndrrat tonat tē pafajshme, tē dëlira:
 vampirë tē vdekur e vdekje vampirësh.*

6

*Lemurë tē kurdisur demodè,
 kuvende, parlamente demodè,
 Cezarin përshëndesin demodè,
 dialogët, monologët demodè,
 regjité e spektaklet demodè.*

*Në sytë e mi: skena demodè
 ku luhen tragjedira demodè.*

7

*Në dorë tē kryeqytetit — kryeqytetet:
 potirë xixëllues kristalesh, qelqesh,
 mbushur me gjak tē Lirive tē mitura,*

*me gjak të valë Dashurish të parrituru,
 me britma jete që thërrasin gjithkund:
 tragjeditë e llahtarshme
 i luajnë aktorë xhuxhë!*

*Për nder! Do buzëqeshja, po kam frikë,
 mos dhe buzëqeshja ime është e vjetër ...
 Tmerrësisht.*

II. Mos
e braktisni
Hiroshimën



ÇFARË KERKOJMË NE NË OQEANËT QIELLORË?

Çfarë kërkojmë ne në oqeanët qiełlorë,
 në tejqiejt e panjohur, ç'kërkojmë ne?
 Sikur tē takonim fluturimin e një pikële uji,
 një çast jete xixëllonje, sikur tē takonim!
 Do t'i pagëzojmë me emra tē rinj planetët,
 galaktikat e porsazbuluara, —
 po... sikur tē takonim ullirin
 dhe pëllumbin e Noes atje, përtej përmbytjeve qe-
 llore.

Do t'i korrektojmë sérish e sérish udhëtimet tonas, —
por ah! sikur një zë...
një dashuri universi tē na bënte tē kthenim kryet an-
dej, —

nga ku errësirat e frikshme qiełlore.
s'jetojnë më dot pa ne.

GJIRI I PAPIRE

në çdo gjysmë sekonde vdes në botë
 një fëmijë ...

*Një arkivol i vogël, gjysma e sekondës ...
 T'u flas senateve, parlamenteve,
 burrave të shteteve?*

*Si fëmija që heq gishtin prej goje,
 me gisht t'u tregoja një gjysmë sekonde
 që lundron brenda një varri?*

*Do të doja prej zemrave të nënave
 të shkulja rrënjet e errëta të dhimbjeve,
 që ndjell gjiri i papirë.*

*Dhe ju, duke shkelur mbi gjysma sekondash,
 pse të shkoni në varreza fëmijësh,
 ku trëndafilët ngatërhojnë fjalët e para —
 të jetës apo të vdekjes?*

SHATILA S'KA MË

Dhe tani: Shatila s'ka më ...

*Gojët e radiostacioneve
pastrohen shpejt e shpejt me furçën e dhëmbëve.*

Gjithçka e bardhë: Shatila s'ka më ...

*As mua në gjumë
s'vjen më të më mbytë
ankthi i krimtit:
kemi parë Dahahët, Bukenvaldët, —
apo jo?!*

*Dhe nuk e kuptoj, nuk e njoh dot,
atë që tani po më flet
me prapagojën, prapagjuhën e kohës:
Shatila s'ka më ...*

HIROSHIMA

*Presidenti dhe piloti,
inxhinieri dhe shkencëtari,
zoti i luftrave të voçkëla dhe zërthimi i atomit,
mekanizmi i gjenisë së vrasjes së njeriut, —
më në fund u ndalën në stacionin e vet: «Vdekja e
Hiroshimës».*

*Por ajo ngrihet për ju me një dashuri përtej jetës e
vdekjes.
Mes errësirës epokale të çmendurisë njerëzore
qëndron si një kandil përjetësisht i ndezur.
Jo Ajo — ju keni nevojë për të.*

Mos e braktisni Hiroshimën trime dhe të pavdekshme.

... Krimi tmerrohet prej dashurisë — Hiroshima.

DJEGIA E BIBLIOTEKËS SË ALEKSANDRISE

Tani në duart tona një shirit i shpërbërë
filmi, i djegur ...

Kush është spikeri? Historia?
I lodhur zëri i saj, i pasigurt:
nata ndizej nga zjarri i bibliotekës
së Aleksandrisë.

Në tempullin e tyre
poetë e filozofë fllojoheshin.
Kush ia vuri zjarrin? Një gaztor?
Një i marrë, apo një Cezar-askushi?
I lodhur, i pasigurt zëri i historisë:
Kujtesa e botës shkrumohej
dhe një flakë verbuese digjej
 brenda bebëzës së syrit.

Befas ndriste vetëm terri,
pastaj më e thellë binte nata e njerëzimit.

VRASJA E PENTESILESE

*Ah, që qenkemi Akilë! Oh, që qenkemi Akilë!
 Këmbët gjith' flatra, në pikën e gjakut brofim
 nën muret e Trojës: përditë
 vrasim Pentesilenë . . .*

*Kur ushta e saj s'është veç dora hënore
 e femrës shtrirë drejt nesh;
 zëri kërcënues s'është veç joshje
 e ethëshme dashurie që fshehtas shkrumbon.
 Oh, që jemi Akilë! Në pikën e gjakut
 vrasim Pentesilenë.¹⁾*

*Pastaj . . . Pastaj . . .
 shikimi njerëzor errësohet, ngrin, —
 tmerrohemë prej bukurisë hutuese,
 vdekjes së ajërt të saj.*

Kraharori i kohës ngashären e dëneset.

*Ne qajmë
 me lotë Akili.*

1. Pentesileja — komandantja e amazonave që luftoi për të mbrojtur Trojën kundër grekëve. U vra prej Akilit. Figura e saj është përpunuar përherë prej artit.

PENELOPËS

Nuk ka mbaruar endja e pëlhirës, Penelopë.
 Ende nuk është kthyer nga Troja Odiseu.
 Ishujve të kohës endet ...
 Po vuri këmbën mbi bregun e thatë
 me vdekje dhëndurësh do ta mbjellë Itakën.
 Vazhdo të endësh, Penelopë.
 Rrahja e avlëmendit tënd
 është krismë e përjetshme e valëve të Jonit.
 Ti mos u mërzit, mos u lodh duke pritur, o grua.
 Kemi nevojë për një ëndërr malli në sy,
 dhe vetë ajo, Dashuria, ka nevojë për pafajësinë tonë.

Mos më moho, Penelopë.

NDANË UDHE FLISTE ESKILI

Ndanë udhe më fliste Eskili.

— *Dhe Hera, thoshte, e hodhi shëmtirën e vet
në humbellë, pjellën e saj e mohoi.
Unë... ç'të bëj unë?!*

*Në çdo pikë gjaku, në çdo qelizë truri,
duhet ta lind e rilind
potin bastard të Herës-Efestin,
që farkon e mbërthen vargonjtë
dhe ecën e plagos dheun.*

*Ndryshe,
ndryshe,
ndryshe*

*në çdo pikë gjaku e qelizë truri —
Si mund të krijoj Prometeun?*

Ndanë udhe më fliste Eskili.

PO ÇFARË BËJNË ATA ATJE?

Po çfarë bëjnë ata atje,
 në Olimp — dy pashë mbi kryet e mia! —
 Çfarë bëjnë ata Zotat, Perënditë:
 që të dashurojnë na u kthekan në shi,
në mjegull,
 mohojnë veten — bëhen shpendë ...
 Ashtu i joshkan dashuritë e tyre ...
 Kur ne, dykëmbëshit e vdekshëm,
ne Askushi, Mosgjëja,
një grusht kockash, mish i gjaku,
 brenda vetes sonë gjëmojmë: — Ku je, Dashuri?
 Dhe ajo përgjigjet: — Këtu!
 — Ku je, Dashuri?
 Dhe ajo: — Përjetësisht këtu!

Vetëm dridhja e zërit të saj
 na shkëput si ortekun malor,
 që shungullon e humnerat i mbush
 me shpirtin e tij të bortë.

Çfarë bëjnë ata aty,
 në Olimp ... Zeusat?!

FYELLI I TOMORIT

poetit **Xhevahir Spahiu**

*Më zuri në udhë fyelli i Tomorit.
 Një lindje e përndritshme elegjie
 fërgëllonte në ajër
 si një perëndi pellazge.*

*Thërrmoheshin mitet e ribëheshin në çast.
 Një heshtje stoike kumboi tek unë:
 në kraharorin e njomë të përjetësisë,
 zemër krejtësisht e ré, —
 Dashuria rrahu!*

*Në mes të udhës po qaja
 me lot gëzimi të fyeyve — njëqind burimeve
 të tua, Tomor.*

ESHTE E DHIMBSHME AULONA E ZHDUKUR

*Ka një çip në mendimet e mia për ty:
atje ku puqet Adriatiku me Jonin,
ku yjet si zilet e shkollës
tingëllojnë mbi fëmijërinë time.*

*Është një vendth midis qiparisave të urtë
të Ishullit¹ tim:*

*atje, prej zérave të shkumës së detit
do të ribëjë sërish.*

*Mbaj një përrallë në sytë e mia për ty:
është tepër e dhimbshme Aulona e zhdukur ...*

*Dhe dashurive moderne
iu dashka të shkelin nëpër rrugët antike
të vdekjes.*

1. Ishulli i Manastirit, Vlorë.

P I R R U A

«Të gjithë shkrimtarët janë njëzëri të mendimit se asnje mbret, qoftë nga bashkëkohësit e Pírrros, qoftë nga ata që kanë jetuar më përpara, nuk mund të krahasohet me të; rrallë mund të shihej, jo vetëm midis mbretërve, por edhe midis burrave të shquar, një njeri kaq pa të meta dhe kaq i drejtë. Aq mirë e njihte ai artin ushtarak, saqë duke luf-tuar me Lysimakun, Demetrin, Antigonin, me këta mbretër të mëdhenj, ai dilte gjithmonë fitues... At-dheun e tij, një vend të vobegjtë e të padëgjuar, ai me lavdinë e heroizmave të tij dhe me shkëlqimin e emrit të tij, e bëri me të vërtetë të përmendur në gjithë botën».

Justini

1.

*Do të kapërcejmë Jonin, mbreti im, —
matanë janë romakët.*

*Syri i stuhishëm
i natës do të na përpjë, por ne,
me not do t'i kërkojmë brigjet —
dhe do t'i gjejmë. Kreshpëria e tyre
do të lëmohet nën gjurmën tonë.
Ne do të thërrasim: «Këtu jemi!».*

2.

*Velat e natës do të dridhen
të mbushura me shfryrjet e stuhishme
të shpirtit mollos.*

Koha do të rinisë lundrimin e saj.

'Ti e di, mbreti im, përpëra është Argosi...)

3.

*Pranvera e viti 280 vjen me dhëmbë elefantë:
i fildishtë gjaku romak
do të kullojë prej tyre.
Heraklia më dysh do të çahet
nga goditjet e klithjes thesprote.*

*Në ballin tonë Dodona
parathotë — e nuk do të na e shkoqisë
fatin.*

*(Unë e ti e dimë, o Pirro,
dikë do të takojmë në Argos).*

4.

*Nesër Hanibali do të thotë për ty
se je më i pari ndër komandantët e kohës. —
Por është e trishtuar Birkena,
e me zëra malli na lutet të kthehem
nëpër udhën që çon*

*lugut tē gjirit tē saj hënor. —
Pse tē mos kthehem, o Pirro?
Veç Hanibali . . .*

5.

*279-ta do tē vijë me fitore, mbreti im.
Ti do tē buzëqeshësh: — «Edhe një si kjo . . .»,
do tē na thuash hidhur.*

*Dhe vetë do tē dëgjosh — jo mua —
zëra tē tjerë që do t'u mësojnë fëmijëve:
«Fitore si e Pirros. . .».*

6.

*Buzëqeshja mollose murmurin:
«Fitore si e Pirros. . .».*

*Jo nën hark triumfi, nën tē,
do tē kalojnë orët e urta tē historisë,
libra tē përdorur, fletore, kalema,
duar tē pasigurta fëmijësh
do tē brumosin lëndën:
«Fitore si e Pirros. . .»*

*Nëpër kuptimin e humbjes,
fitorja me fletë lisi
prek epitafet.*

7.

*Tolemeu, yt bir, nesér do tē vritet.
 Kur para teje do ta sjellin,
 ti do tē thuash: «Vdiq
 më vonë nga ç'ia kisha frikën».*

*Në fjalët e tua do tē hyjnë
 etërit e urtë tē Epirit:
 do tē takojnë fatin tragjik tē tyre.*

8

*Kam një dhimbje për ty, mbreti im.
 Nuk mund tē shoh, veçse me sytë e tu:
 Maqedoninë, Athinën,
 Taranton, Askolin, Beneventon,
 me sytë e tu shoh Argosin, —
 dhe nuk mund t'i flas veçse
 me gojën tënde:
 mbeti këtu lavdia tragjike e Epirit,
 tē cilën as vdekja s'guxoi ta shohë në sy.*

9.

*Kam një dhimbje për ty, o Pirro.
 Mesdheu — në pëllëmbën time:
 Aleksandria, Kartagjena, Roma. —*

*Dhe ne, ullinj tē gjelbër,
në brigjet e detit tē gjaktë tē jetës.
Ne që njohim vetveten
në lavdinë tönë tragjike.*

10.

Më mirë që takohemi në Argos.

*Tre demat janë therur prej kohe,
e akoma jetojnë ...
Mjegullor Zeusi i Dodonës,
na sheh nga bebëzat e tyre.*

Më mirë që takohemi në Argos.

11.

*Jam i vetmi që di tē shkoqis
shushurimën e lisit tē Dodonës?
Tē kap emrin e Antigonës,
tē Lanasës, tē Birkenës, —
në zhurmën e hirit tē vdekjes sate,
brenda urnës së vogël.
Nga syri i natës ilire derdhet Aoosa, —
ha brinjët e dheut
dhe zbulon statuetkat e vogla
tē dashurive dhe lirive tonë.*

Dikujt do t'i duhen.

12.

Fytyra jote derdhur në bakër të ndryshkur.

Cilin do të shpérblejmë me atë monedhë, o Pirro?

Fatin tonë?

Perënditë e egra

kërkojnë fli përherë të reja, —

kurrë nuk u zbutën.

Me monedhën e bakërt

cilin do të shpérblejmë?

13.

Po nesër Hanibali do të thotë për ty . . .

Nesër do të jemi legjendë,

të vërtetë dhe të pavërtetë;

do të jemi fli

të zotërve të Dodonës: — nesër

ti vetë do të habitesh,

kur të shohësh kohërat, si galat,

të ushqehen tek ti me gojëdhëna.

Mitikë do të jemi nesër . . .

14.

Dhe ti do të thuash: — Tani,

jo unë — lufta

nuk jeton dot më pa mua.

Ajo dhe jo unë i trembet Argosit.

*I papärlyer si zéri yt,
ku tē tē kérkoj?*

*Në Benevento,
apo në Argos?*

*Vetë lavdija e ka gojën tē hidhur,
sa përmënd emrin tënd:
«Asgjë s'i trishton ullinjtë
më shumë se udhët e luftës...»*

1. Pirrua u vra në vitin 272 p.e.s. në luftë për pushtimin e qytetit Argos.
2. Antigona, gruaja e parë e Pirros ishte bijë e Tolemeut të Egjiptit; pas vdekjes së saj ai u martua disa herë për të forcuar lidhjet mbretërore. Birkena është e bija e mbretit Bardhyl, dhe Lanassa e Agathoklit të Sirakuzës.

IV. Përkthime

Shqipëri është një shtet me 28 milion banorë.

IV. Përkthime



NGA POEZIA E LASHTË EGJIPTIANE...

VETËM TË TË SHOH

*Aq të vogla janë lulet e Seamus,
 sa kush i sheh
 vetja i duket gjigant.
 Unë jam mikja jote e parë ...
 Unë jam për ty si kopshti,
 që bar e lule plot erë
 ngado ka shpërndarë.
 Është i këndshëm hendeku që ke hapur
 në flladin e erës së veriut.
 E bukur udha ku eci,
 kur dora jote në timen
 pushon me gëzim ...
 Zëri yt është nektar
 që jetë më jep.
 Dhe vetëm të të shoh — është për mua
 më shumë se buka e uji.*

anonim egjiptian

TI, BURIM I DËSHIRUAR

*Ti, burim i ëmbël për të eturin në shkretëtirë.
 Ai është i mbyllur për atë që këtu flet.
 Është i hapur për atë që këtu hesht.
 Vjen ai që hesht dhe atëherë e gjen burimin.*

anonim egjiptian

KAQ SHTRËNGIM NË ZEMËR

*Kaq shtrëngim në zemër për dashurinë
 sa gjysma e flokëve m'u shthurën
 duke bredhur të të dal përpara...*

*Po shkoj t'i bëj sërisht kokorodhe,
 të jem gati çdo çast.*

anonim egjiptian

KUR MË PËRQAFON

O lule të Mekmekhut — jepmëni paqë!
 Do të bëj për dashurinë time
 atë që zemra më thotë.
 Kur ti më përqafon,
 balsam për sytë do të doja, —
 sepse të të shoh është dritë.
 Folezë e kam brinjën tënde,
 sepse e ndiej që më do
 ti — që midis gjithë njerëzve,
 për zemrën time je më i madhi.
 Sa i bukur është ky çast imi!
 Të mundte gjer në përjetësi të vazhdonte,
 kur unë çlodhem me ty.

anonim egjiptian

«JAM I SËMURE»

Zgjas kryet te dera, —
 a po vjen i dashuri?
 Sytë e mi u ngulën në udhë,
 veshët e mi dëgjojnë
 për të kapur çapin e tij.
 Dashuria e mikut tim
 është pasuria e vetme që kam
 dhe për të, dashuria ime nuk hesht.
 Ai më dërgon një lajmës të shpejtë
 që më thotë: «Jam i sëmure ...».
 Thuamë më mirë
 se ke gjetur një tjetër!
 Përse ta bësh që të vuajë zemrën e saj
 dhe timen?

anonim egjiptian

DASHURIA E SË BUKUREŞ

*Dashuria e së bukurës sime është në bregun tjetër.
 Një kërrabë lumi rrjedh ndërmjet nesh
 dhe krokodili në shtratin kumor.
 Kridhem në ujë, notoj mbi valë.
 E fuqishme është zemra ime nëpër dallgë
 dhe uji është si tokë për këmbët e mia, —
 aq të fortë më bën dashuria e saj:
 një mrekulli është lumi për mua.*

anonim egjiptian shek. XIV-XV p.e.s.

GJAKA

Nganjek që dashurit e marrëvullid e

plashtojnë e gjithpërmend

që dashurit e marrëvullid e

që dashurit e marrëvullid e

NXITIMI I TË DASHURIT

Ah, sikur të vije ti me nxitim
 tek e dashura jote, —
 si ai lajmëtari besnik,
 i shtyrë nga padurimi i të zot
 për lajmin e rëndësishëm që sjell.
 Zemra është tendosur për ta dëgjuar,
 dhe gati, nën shalë, janë gjithë kuajt
 për t'u këmbyer.
 Koçia po pret në fushë,
 s'ka kohë as të marrësh frymë . . .
 Arriti në shtëpinë e së dashurës,
 zemra në festë.

anonim egjiptian

S A F O

O ballëstolisura me vjollca, hyjnорja
buzëqeshje e ëmbël, Safo.

Alkeu

A F E R D I T E S

O Afërdita ime me shtatore mbuluar me lule,
ti e pavdekshmja, bijë dredharake e Zeusit,
të lutem

mos ma mundo shpirtin
me brenga e dhimbje,
por eja tek unë, ashtu si atëherë
kur sapo ndieje zërin tim lutës,
nga larg

vije... E lije shtëpinë atërorë
mbi qerre ari...

Duke rrahur krahët
në ajrin qiellor,
harabelë të hijshëm
të prunë
në tokën e murme:

Përnjëherësh erdhën... Dhe ti, o e lumja,
 buzagaz me fytyrën tënde të pavdekshme,
 më pyete për brengën time të re,
 pse të kërkoja

dhe çfarë dëshironte prapë
 kjo zemra ime e çmendura: «Cilin kërkon që Peito¹
 të shtjerë në dashurinë tënde,
 O Safo? Kush të fyen?

Ai që tani prej teje largohet — shpejt do të të ndjekë
 pas, ai që s'pranon dhuratat e tua — dhurata vetë do
 të të sjellë, ai që tani ty nuk të do — qoftë kundër dëshirës së
 vet! — shpejt do të të dashurojë».

Eja tek unë tani, në qoftë se më do,
 dhe çlirimë nga vuajtjet,
 U bëftë gjer në fund çfarë do shpirti im...
 Ndihmomë, o Afërditë.

1) Peita — perëndesha e Bindjes.

GONGILEŞ²

*Gongila, vishe tunikën e bardhë
dhe eja para meje. Drejt teje
vjen dashuria.*

*Dridhet kush të shikon kështu të stolisur.
Dhe unë kënaqem se
bukuria jote qorton
Afërditën.*

2) Një nga poezitë tipike që i këndoheshin nuses ditën e dasmës dhe quheshin «epitalame».

KA PERENDUAR HËNA

*Ka perënduar hëna
dhe Plejadat në mes të natës
shpërndajnë rininë.
Dhe unë e vetme kam mbetur.*

*Shpirtin tim
Erosi e shkund, si era e maleve që çan lisat.*

*Zbërthen Erosi gjymtyrët
si një bishë e ëmbël dhe e hidhur.*

*As bletë dhe as mjaltë.
Dhe vuajtje e dëshirë.*

HËNAPLOTE

Yjet përqark hënës së bukur
 fshehin fytyrën e saj të shndritshme,
 aherë kur ajo e plotë, shkëlqen më shumë
 përmbi tokë. e bardhë



*Dikush thotë një ushtri
kalorësish, e dikush këmbësorësh,
tjetërkush një ushtri anijesh të rreshtuara
pranë bregut të murrmë:
por unë them atë që çdo njeri dashuron ...*

*Dhe do të desha të shikoja
hapin e dashur të Anekторies
dhe rrezatimin e shkëlqyer të fytyrës së saj.*

* * *

Fola nëpër ëndërr me ty, Afërditë.

I BARABARTË ME ZOTAT MË DUKET AI

*I barabartë me zotat më duket ai
 që pranë teje rri, si nëpër èndërr,
 dhe dëgjon një zë aq të èmbël
 ndërsa ti flet ...*

*Dhe qesh me të madhe. Në çast
 zemra më gufon në kraharor
 apo të shoh ty... dhe zëri
 më shuhet*

*në gjuhën e ngrirë. Një zjarr
 i bestë përndizet në lëkurën time,
 në sy errësirë, vërshim
 i gjakut në vesh.*

*E mbytur në djersë dridhem,
 zbehem si bari i shkelur,
 dhe vdekja e shpejtë për mua.*

ERMESIT

*Ermes,
kam kohë e kohë që të thërras:
ndihmomë ti, o despot,
sepse vdekja nuk vjen vetë ...
Asgjë nuk më gjëzon sa ngushëllimi.*

*Unë dua të vdes,
të shoh brigjet e Akerontit
mbushur me nenufarë të larë nga bryma e vesës.*

FTESEË PER NE ERANO

Ejani në tempullin e shenjtë të virgjëreshës,
ku më i dashur është pylli dhe mbi altare
digjet temjani.

Këtu gurgullon ujët e freskët nëpër degë
të mollëve; fusha shtrihet nën hijen
e trëndafilave
dhe qetësi e thellë lind nga fëshfëritja
e gjetheve.

Këtu fusha ku mërzejnë kuajt
është plot me lulet e pranverës
dhe anitet¹ kundërmojnë ...

Dhe këtu sundimtarja e Qipros²,
derdh nëpër kupa floriri
verë të qashtër qiellore
me gëzim.

1) Anitet — lloj luleje
2) Afërdita

OAKA SWEDEN

NUK DO TË TË KUJTOJË MË ASKUSH

*Ti do të vdesësh... dhe nëpër kohëra më s'do të të
kujtojë*

*askush, për ty dashuri s'do të ndiejë,
sepse nuk kujdesesh më për trëndafilat e Pierisë¹.*

*E panjohur — nëpër banesat e Adit —
do të endesh midis të vdekurish të errët,
duke bredhur.*

1) Atdheu mitik i muzave. Muzat vetë thirreshin edhe «Pieride», sepse adhuroheshin në Pieria.

MBI FLOKËT E BUKUR VËRE KURORËN

*Mbi flokët e bukur, o Dikë, ti vëre kurorën
 të thurur prej duarve të njoma me degëza aneti,
 sepse gjithë gëzim presin Haritet¹ atë,
 që me lule stoliset. U ikin të pakurorëzuarve.*

1) Perëndeshat e gëzimit

NDRIÇONTE HËNA E PLOTË

*Ndriçonte hëna e plotë,
 kur para altarit qëndruan
 kretaset¹ me këmbët e lehta,
 plot hir nisën të ecin përqark altarit,
 të shkujdesura mbi barin e njomë që sapo kishte
 mbirë.*

1) Vajzat prej Krete

DUKE KUJTUAR SHOQEN E LARGET

... Në Sardi
shpesh me mendje kthehesh.

Në kohën tonë atëherë,
kur perëndeshë ishe për të
dhe (Sardi) në këngët e tua lumturohej.

Tani, midis grave të Lidisë,
sapo humb dielli, spikat
hëna me rrezet e kuqe.

Të gjithë yjëzat i mposht
dhe drita e saj luhatet mbi ujët e detit
dhe mbi fushat nga bari mbuluar.

*Vesa e mbush me dritë trëndafilin,
mbështetet mbi trumëzën e brishtë
dhe mbi fletën e tërfilit si lule.*

*E vetmuar duke u endur
mendon herë-herë për Atidën
dhe zemra i shpërthen duke thirrur: Eja!*

*Dhe kjo thirrje me këtë zë të njohur,
rrokje për rrokje kumbon te ne,
duke fluturuar përmbi det.*

MEMER VJEDHË NË
PO VDES ADONI I NJOMË

PO VDES ADONI I NJOMË

*Po vdes Adoni i njomë, o Kiteri, ne ç'do të bëjmë?
 Goditni me grushte kraharonin, o vajza, dhe çirrini
 rröbet; i grisni.*

SI MOLLEN E ËMBËL

*Si mollën e ëmbël që skuq majën e degës
lart, atje lart... E harruan ta vjelin mbledhësit ...
Jo, s'e harruan... Por më kot u orvatën
ta arrijnë ...*

SI JASEMINI

*Si jasemini që nëpër male e shkelin me këmbë
barinjtë, dhe lëshon gjak e purpurta lule . . .*

PERMBAJTJA

I. ENDERRA TË MIA

	Faqe
Qenka më vështirë	5
Endrra të mia	6
Një përkresë me gjethe ulliri te koka	8
Ku shkonit ju, statuja	9
Jemi bërë prej lavdie poetike	17
Bën sikur	18
Hipokrizi, nuk je e bukur	19
Më njerëzore	20
Si mund të kalohet Llogoraja pa ty?	21
Stuhia	22
Një zog i madh	23
U zverdh ligjërimi i dallëndyshes shtegtarë	24
Mjellma e liqenit të Ohrit	25
Dashuritë janë të shumta	26

Kishte çelur lulja e ullirit	30
Eshtë një lojë	31
Sa çel e lidhet vjeshta	33
Ndarja	34
Moj e vogëla sa loti	35
A je brymë, moj, a je borë?	37
Sa qava për ëndrrën, moj	38
Varrin mos ma bëni thellë	39
Motive nga Berllini	40
Rekuiem për H.F. Karajanin	43

II VËLLEZËRIT E PEGASIT

Vëllezërit e Pegasit	47
Dy herë nënë	48
Vajet e Ballkanit	49
Orakuj të errët	53

III. MOS E BRAKTISNI HIROSHIMËN

Çfarë kërkojmë ne në oqeanët qiellorë?	59
Gjiri i papirë	60
Shatila s'ka më	61
Hiroshima	62
Djegia e bibliotekës së Aleksandrisë	63

Faqe

Vrasja e Pentesilesë	64
<u>Penelopës</u>	65
Ndanë udhe fliste Eskili	66
Po çfarë bëjnë ata atje?	67
Natyrisht që Qezarët vdesin	68
Macja	69
Fyelli i Tomorit	70
Eshtë e dhimbshme Aulona e zhdukur	71
Pirrua	72

IV. PËRKTHIME

Vetëm të të shoh	81
Ti, burim i dëshiruar	82
Kaq shtrëngim në zemër	83
Kur më përqafon	84
Jam i sëmurë	85
Dashuria e së bukurës	86
Nxitimi i të dashurit	87
Afërditës	88
Gongilës	90
Ka perënduar hëna	91
Hënäplotë	92
Dikush thotë	93
Fola	94
I barabartë me zotat më duket ai	95
Ermesit	96

Faqe

Ftesë pér në Erano	97
Nuk do të më kujtojë më askush	98
Mbi flokët e bukur vëre kurorën	99
Ndriçonte hëna e plotë	100
Duke kujtuar shoqen e largët	101
Po vdes Adoni i njomë	103
Si mollën e ëmbël	104
Si jasemini	105
Mbrëmjes	106
O vajzëri	107
Unë e dua atë	108
Shoqe të dashura	109

Arapi, Fatos

Ku shkoni ju, statuja...; Poezi/
Fatos Arapi; Red.; S. Arbana. —
T., Naim Frashëri, 1990. — 116 f;
18 cm:

891.983 — 1

A 73

W derëzua për shtyp në maj 1990

Bell nga shtypi në shtator 1990

Tirazhi 5000 kopje

Formati 60x88/16

Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë 1990